



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 894/2 prot

Datë 28.04.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AI” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me REF-20266-02-22-2022, me objekt: “Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë” me fond limit 158,972,395.02 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë pesë.02) Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Agri Construction” SHPK
Rruga e Dibrës, Ish.Trup.Shk.Skenderbej 3, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës Nr 1001 Tiranë
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Dion-AI” SHPK
Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla 2, kati 2, Tiranë

Në datën 28.04.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 894 prot., datë 28.04.2022 e operatorit ekonomik “Agri Construction” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me REF-20266-02-22-2022, me objekt: “Rikonstruksion i godinës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë” me fond limit 158,972,395.02 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë

pesë.02) Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dion-AI” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Agri Construction” SHPK në ankesën me nr. 894 prot., datë 28.04.2022, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Dion-AI” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Dion-AI” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

2.3.7. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar në list-pagesa:

a. punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI (ish –IQT) ose ekuivalente me të, të vlefshme:

- min 1 (një) teknik ndërtimi,
- min 3 (tre) punonjës elektrikist/elektroteknik;
- min 2(dy) punonjës hidraulik;
- min 3 (tre) punonjës mekanik/elektromekanik;
- min 2 (dy) punonjës murator;
- min 2 (dy) punonjës pllakashtrues;
- min 2 (dy) punonjes bojaxhi;
- min 1 (një) saldator,
- min 2(dy) punonjës hidroizolues,
- min 1 (një) hekurkthyes;
- min 2(dy) punetor d/alumini;
- min 2 (dy) punetor cmontimi dyer,dritare;
- min 2 (dy) suvatues;
- min 2 (dy) specialiste per tavane te varur (gipsi);
- min 1(një) nivelues betoni

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitede perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”**.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 28.04.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Anëtar

Anëtar

Fioorent Zguro

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri